



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2022:181228

Datë: 04.03.2024

Numri i dokumentit: 05576977

C.nr.1115/2022

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË GLLOGOC-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, si gjykatë civile e shkallës së parë, me gjyqtarin Jeton Krasniqi dhe me sekretaren juridike Ajshe Thaqi, në kontestin e paditëses E.H nga Glllogoci, të cilën me autorizim e përfaqëson J.I nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Glllogocit me seli në Glllogoc, për shkak të anulimit të vendimit dhe kthimit në vendin e punës, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, me dt. **04.03.2024**, në prani të autorizuarit të paditëses e në mungesë të paditurës mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET** në tërsi si e bazuar kërkesëpadia e paditëses E.H nga Glllogoci.
- II. ANULOHEN** Vendimi i Drejtorisë së Arsimit nr... i datës 04.07.2022 dhe Vendimi i Komisionit të Ankesave të paditurës 01.Nr... i datës 18.08.2022, si të kundërligjshme.
- III. DETYROHET** e paditura Komuna e Glllogocit me seli në Glllogoc, që paditësen E.H t'a kthej në vendin e punës Profesor i I... në SHMP "F..." në Glllogoc.
- IV. DETYROHET** e paditura Komuna e Glllogocit me seli në Glllogoc që paditëses në emër të pagave të pa paguara neto, respektivisht për periudhën nga data 01.11.2021 deri me datë 12.02.2024, t'ia paguaj shumën prej 8,241.66 €, si dhe në emër të kontributeve pensionale që duhet të paguhen në emër të paditëses në Trustin Pensional të Republikës së Kosovës për muajt nga periudha 01.11.2021 deri më 12.02.2024 shumën prej 923.72 €, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës në shumën prej 584 € në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

I. Pretendimet e palëve dhe kërkesëpadia

Paditësja E.H përmes të autorizuarit të saj J.I ka parashtruar padi në gjykatë, kundër të paditurës Komuna e Glllogocit me seli në Glllogoc, me objekt të padisë anulim i vendimit të Drejtorisë së Arsimit nr... i datës 04.07.2022 dhe vendimit të Komisionit të Ankesave të paditurës 01.Nr... i

datës 18.08.2022, si të kundërligjshme, kthimin e saj në vendin dhe detyrat e saj të punës dhe detyrimin e palës së paditur që t'i paguajë të ardhurat personale, si dhe shpenzimet procedurale.

Paditësi në padi ka theksuar se brenda afatit ligjorë prej 30 dite ka parashtruar ankesë kundër vendimit të Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Glllogocit nr... të datës 04.07.2022 me të cilin në mënyrë të kundërligjshme i janë shfuqizuar dispozitat e kontratës që kanë të bëjnë me kohëzgjatjen e marrëdhënies së punës. E paditura e ka cilësuar ankesën si të jashtëafatshme pasi që duke u referuar në Ligjin për zyrtarë publikë kanë konsideruar se duhet ti përmbahej afatit prej 15 dite për parashtrimin e ankesës, mirëpo me vendimin e kontestuar e paditura nuk i dhënë fare këshillë juridike për ankesë dhe nuk i ka caktuar afatin. Prandaj në dritë të këtyre fakteve është vlefshëm afati 30 ditor për parashtrimin e mjeteve juridike bazuar në Ligjin e Procedurës së Përgjithshme Administrative i cili është ligj special në këtë çështje në kuptim të afateve dhe procedurave, përkatësisht neni 127 të tij në të cilin është përcaktuar afati 30 ditor për ankesë.

Paditësja nga viti 2021 kishte themeluar marrëdhënien e punës në DK Drenas në cilësi të Profesorit të I... në kuadër të SHMP "F..." fillimisht me afat të caktuar ndërsa nga data 09.05.2022, ka nënshkruar kontratë pune për mësimdhënës në kohë të pacaktuar. Me datë 04.07.2022 Drejtori i Arsimit i Komunës së Glllogocit ka nxjerrë vendimin nr... me të cilin ka shfuqizuar nenin 4.1 të kontratës së lartshënuar të punës të dt. 05.05.2022, si dhe ka përcaktuar se kontrata e punës skadon me datën 31.08.2022. Me vendimin e drejtorit komunal të arsimit është vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo e plotë e gjendjes faktike sepse nuk është bazuar në asnjë provë dhe asnjë dokument për të vërtetuar konstatimet se skadimi i kontratës duhet lidhet me konkursin e vitit shkollor 2021/2022 sepse tanimë në fuqi është kontrata e datës 09.05.2022, e cila bazohet në dispozitat ligjore të Ligjit të Punës dhe Ligjit për Arsim prandaj konkursi i referuar nuk ka më tutje fuqi ligjore. Vendimi i atakuar nuk ka ndonjë mbështetje ligjore dhe as provë se ku mbështetet konstatimi se Kolegji H... nuk është adekuat për lëndën e i... Vendimi i atakuar nuk mundë të mbështetet në asnjë dispozitë ligjore dhe i njëjti është formuluar në mënyrë të çuditshme duke e titulluar si shfuqizim të nenit 4 të kontratës që ka të bëjë me kohëzgjatjen e kontratës së punës, e që në fakt është ndërprerje e marrëdhënies së punës pasi që sipas kontratës, marrëdhënia e punës është me afat të pacaktuar, ndërsa me anë të këtij vendimi kontrata e punës ndërpritet në fund të muajit përkatësisht me datë 31.08.2022. Drejtori i arsimit nuk është bazuar në nenin 69 të Ligjit të Punës ku është paraparë afati për njoftimin e ndërprerjes së punës dhe një ndërprerje e tillë e marrëdhënies së punës është e kundërligjshme. Drejtori i Arsimit, vendimin e tij e ka mbështetur në nenin 54 ika 1.2 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative në të cilën dispozitë përcaktohen kushtet ligjore për anulimin e akteve administrative të paligjshme ndërsa në këtë rast nuk kemi fare akt administrativ paraprak por kontratë të punës me afat të pacaktuar, ashtu që Drejtoria Komonale e Arsimit (DKA) është mbështetur formalisht në këtë dispozitë ligjore por ka vepruar në kundërshtim me përmbajtjen e saj. Më tutje ka theksuar se anamolaia e këtij akti juridik të atakuar qëndron në atë se bazohet kinse në dispozita ligjore për anulimin e akteve administrative ndërsa në dispozitivin e tij përcaktohet shfuqizimi i një neni të kontratës së punës. Por edhe shfuqizimi i një pjese të kontratës është i kundërligjshëm sepse në radhë të parë marrëdhënia e punës nuk është lidhur me akt administrativ por me kontratë të punës dhe së dyti ka vepruar në kundërshtim me dispozitën ligjore me kushtet për shfuqizimin e akteve administrative përkatësisht në kundërshtim me nenin 57 par.1 të LPPA sepse nuk ka pasur kurrfarë ndryshimi të situatës pasi që vendimi i punës ekziston dhe po ashtu nuk ka asnjë ndryshim tjetër në plan program të shkollimit ndryshe nga ato që ishin në kohën e lidhjes së kontratës.

Në seancën kryesore i autorizuari i paditëses ka deklaruar se mbetet në tërsi pranë padisë dhe kërkesëpadisë deklarimeve të dhëna në shqyrtimin gjyqësorë si dhe parashtresës mbi precizimin

e lartësisë së kërkesëpadisë duke shtuar se padia e paditëses është e afatshme ndërsa sa i përket vendimit të shkallës së parë e paditura nuk ka ofruar asnjë provë se paditësen e ka njoftuar me këtë vendim andaj në këtë kuptim e njëjta asnjëherë nuk është njoftuar me përmbajtjen e tij. Nuk ka pasur vërejtje në ekspertizën e ekspertës financiare.

Në fjalën përfundimtare i autorizuari i paditëses ka deklaruar se nga administrimi i provave u vërtetua se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar. Sa i përket afatshmërisë së padisë gjatë procedurës u vërtetua se e paditura nuk ia ka dorëzuar fare vendimin e shkallës së parë paditëses e as vendimin e shkallës së dytë ndërkaq edhe padia është dorëzuar brenda afatit 15 ditor nga data e nxjerrjes së vendimit të shkallës së dytë. Sa i përket kundërligjshmërisë së vendimeve të atakuara siç kemi theksuar në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor, vendimet janë të kundërligjshme pasi që marrëdhënia e punës lidhet në bazë të kontratës së punës dhe se detyrimet dhe të drejtat nga marrëdhënia e punës e rregulluar me ligjin e punës, gjithashtu kontrata e punës nuk është akt administrativ i cili mundë të shfuqizohet sipas LPA-së por është akt individual i cili lidhet mes punëdhënësit dhe të punësuarit me të cilin rregullohen të drejtat dhe detyrat që rrjedhin nga marrëdhënia e punës konform nenit 1.11 të Ligjit të Punës andaj duke u bazuar në të gjitha këto konsiderojmë se vendimet e të paditurës janë të kundërligjshme dhe i propozojmë gjykatës që kërkesëpadinë e paditëses ta aprovoj si të bazuar sipas parashtrësës për precizimin e lartësisë së kërkesëpadisë.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura ka parashtruar përgjigje në padi përmes së cilës e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditëses si të pa bazuar duke theksuar se Drejtoria e Arsimit në Komunën e Drenasit me datë 02.09.2021 ka shpallur konkurs në IAAP “F...” për një mësimdhënëse për i... për vitin shkollor 2021/2022 me kohë të caktuar (me mundësi vazhdimi) në të cilin konkurs ka aplikuar edhe paditësja. Pas mbylljes së konkursit DKA me datë 20.10.2021, ka njoftuar kandidatët të cilët kanë aplikuar për vendin e punës e cila i ka plotësuar kushtet për të iu nënshtruar testit me shkrim. Sipas këtij njoftimi në testin me shkrim kanë hyrë 3 kandidatë dhe që të tre kanë kaluar testin me shkrim pastaj DKA me datë 25.10.2021 ka publikuar njoftimin me të cilin ka ftuar në intervistë me gojë kandidatët të cilët kanë kaluar testin me shkrim. Komuna me rastin e vendosjes në konkursin publik të cekur si më lartë ka zbatuar udhëzimin administrativ nr.07/2017 të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik dhe Udhëzimin Administrativ të MASHT-it nr.05/2021 për Normativin mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm. Komuna duke u bazuar në nenin 7 të UA nr.07/2017 të MASHT ka caktuar komisionin për intervistim dhe vlerësimin e kandidatëve. Nga ky komision në përputhje me nenin 9 është përpiluar lista e aplikuesve në konkurs të cilët kanë plotësuar kushtet dhe kriteret e konkursit, ka ftuar aplikuesit në konkurs të cilët kanë plotësuar kushtet dhe kriteret e konkursit, duke i ftuar aplikuesit e listuar për testin me shkrim në pajtim me nenin 10 ka përpiluar listën e kandidatëve me rezultatet e arritura në testim dhe në pajtim me nenin 11 par.1, ka njoftuar kandidatët të cilët i nënshtrohen intervistës me gojë e gjithashtu në harmoni me pragrafin 9 të nenit 11, Komisioni përzgjedhës pas përfundimit të intervistës ka publikuar listën definitive duke renditur pjesëmarrësit në testim dhe intervistë sipas renditjes së pikëve të fituara nga testi dhe intervista dhe në pajtim me nenin 12 komisioni në fjalë ka nxjerrë vendimin me nr... të datës 22.11.2021 të aplikuesit fituese E.H.

Pas zhvillimit të procedurës rekrutuese e njëjta me datë 05.05.2022 ka nënshkruar kontratën e punës për mësimdhënëse me nr... si profesor i i... në SHMP “F...” në Drenas. Kjo kontratë është lidhur duke u mbështetur në nenin 10 par.2.2 të Ligjit të Punës. Bazuar në kompetencat e tij dhe legjislacionin në fuqi me datë 04.07.2022 ka nxjerrë vendimin me nr... me të cilin e ka shfuqizuar

nenin 4 pika 1 të kontratës së datës 05.05.2023 që ka të bëjë me skadimin e kohëzgjatjes së kontratës. Përfundimi i kontratës lidhet me konkursin e datës 02.09.2021 ku është kërkuar një mësimdhënës i i... për vitin shkollor 2021/2022 me kohë të caktuar, ndërsa e paditura ka vepruar në bazë të nenit 53 par.1 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

E pa kënaqur me vendimin e DKA-së të datës 04.07.2022, paditësja ka parashtruar ankesë me datë 04.08.2022, pranë komisionit të ankesave të cilën Komisioni i ankesave e ka hudhë si të jashtafashëm duke u bazuar në nenin 74 par.2 të Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik për shkak se ankesa nuk është parashtruar brenda afatit 15 ditor mirëpo edhe sikur ti referohemi Ligji nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative përkatësisht nenit 127 të tij ku është përcaktuar se ankesa duhet të parashtrohet brenda afatit 30 ditor nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ e njëjta edhe në këtë rast e ka humbur afatin sepse në bazë të shkresave të lëndës e njëjta e ka pranuar vendimin me datë 04.07.2022 ndërsa ankesën e ka parashtruar me datë 04.08.2022, që i bie se sipas dy ligjeve të lartcekura e ka humbur afatin kohorë. Po ashtu e njëjta nuk i është përmbajtur as këshillës juridike të vendimit të Komisionit të ankesave i cili bazohet në Ligjin nr.06/L për zyrtarët publikë përkatësisht nenit 74 par.5 të tij ku është përcaktuar se nëse ankuesi nuk është i kënaqur me vendimin e organit të ankimit apo në rast se nuk merr përgjigje brenda afatit të përcaktuar në pajtim me par.4 të këtij neni në afatin vijues prej 15 dite mundë të inicioj kontest pune në gjykatën kompetente, e siç shihet në shkresat e lëndës e njëjta vendimin e Komisionit të ankesave e ka pranuar me datë 18.08.2022, ndërsa padinë e ka parashtruar me datë 05.09.2022.

E paditura në përgjigje në padi tutje ka theksuar se paditësja gjatë parashtrimit të padisë pranë gjykatës nuk ka prezantuar asnjë provë të besueshëm për ti vërtetuar pretendimet e saj se vendimi i DKA-së me nr... i dt. 04.07.2022 me të cilin është njoftuar e njëjta për skadimin e kontratës si dhe vendimi 01 nr... i datës 18.08.2022 janë të kundërligjshme sepse e njëjta me rastin e shpalljes së konkursit ka qenë në dijeni se pozita për të cilën ka aplikuar dhe lidhur kontratë për pozitën mësimdhënës/e për i... për vitin shkollor 2021/2022 ka qenë me kohë të caktuar dhe Ligji i Procedurës Kontestimore parasheh se barra e të provuarit bie mbi paditësen pra e njëjta është e obliguar që gjatë shqyrtimit të kësaj çështje ti ofroj provat gjykatës për besueshmërinë e kërkesëpadisë gjë të cilën paditësja nuk e ka bërë, andaj ka propozuar që kërkesëpadia e paditëses të refuzohet si e pa bazuar.

E paditura nuk ka marrë pjesë në seancat e caktuara gjyqësore por përmes parashtrësës me shkrim të datës 10.01.2024 dhe asaj të datës 04.03.2024, ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditëses sikurse në përgjigje në padi.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Meqenëse e paditura nuk ka marrë pjesë në seancën kryesore edhe pse ftesën e ka pranuar në mënyrë të rregullt gjykata duke bazuar në nenin 423 par.3 të LPK-së bazuar edhe në propozimin e të autorizuarës së paditëses ka marrë aktvendim dhe seancën kryesore e ka mbajtur në mungesë të paditurës.

II. Provat e administruara lidhur me vërtetimin e gjendjen faktike

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen kontestuese në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor, sipas propozimit të palëve ka administruar provat e propozuara dhe atë: Kontrata e punës me nr... e datës 05.05.2022; Vendimi i Komunës së Drenasit-zyra e kryetarit me nr... i datës 04.07.2022, ankesa e paditëses me nr... e

datës 04.08.2022; Vendimi i Komunës së Drenit-Komisioni i ankesave për nëpunësit e shërbimit publik nr... i datës 18.08.2022; kërkesa e paditëses drejtuar të paditurës me datë dt. 20.10.2022; konkursi i Drejtorisë për Arsim me nr... i datës 27.09.2022; kontrata e punës me nr... e datës 01.09.2022; flete dorëzimi i Komisionit të ankesave për nëpunësit e shërbimit publik me nr... dhe ekspertiza financiare e datës 12.02.2024.

Gjykata pas vlerësimit të pohimeve të palëve ndërgjyqëse dhe provave të nxjerra në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar.

Në mes të palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se paditësja dhe e paditura kanë qenë në raport juridik të punës, ashtu që paditësja në vitin 2021 ka qenë e punësuar tek e paditura përkatësisht në SHMP “F...” në Drenas si profesoreshë e lëndëve të i... deri në përfundim të procedurave të rekrutimit. Po ashtu në mes të palëve nuk ishte kontestuese se paditësja ka qenë në marrëdhënie pune të njëjtë tek e paditura edhe në vitin 2022 nga data 04.05.2022.

Kontestuese në mes palëve ishte nëse paditësja në bazë të kontratës së datës 05.05.2022, ka qenë në marrëdhënie punë tek e paditura me afat të caktuar apo me kohë të pa caktuar. Po ashtu kontestuese ishte edhe mënyra e vendosjes së shfuqizimit të nenit 4 të kontratës nr... të datës 05.05.2022, pasi që paditësja ka pretenduar se me këtë kontratë ka themeluar marrëdhënie pune me afat të pa caktuar duke e konsideruar vendimin e të paditurës 09... të dt. 04.07.2022 si të kundërligjshëm, ndërsa e paditura ka pretenduar se vendimi në fjalë është i ligjshëm dhe ka të bëjë me skadimin e kontratës sipas të cilit kohëzgjatja e kontratës është dashur të lidhet me konkursin e datës 02.09.2021.

Përveç kësaj kontestuese në mes të palëve ishte edhe afatshmëria e ankesës së paditëses parashtruar pranë të paditurës kundër vendimit të datës DKA-së të datës 04.07.2022 si dhe afatshmëria e padisë pasi që e paditura ka pretenduar se edhe ankesa edhe padia kanë qenë jashtë afatit ndërsa paditësja ka pretenduar se kanë qenë të afatshme.

Gjykata gjeti se me datë 05.05.2022 ndërmjet ndërgjyqësve krijohet marrëdhënie e punës, ashtu që nënshkruhet kontratë e punës. Në bazë të kësaj kontrate, paditësja e cila ishte e kualifikuar në Kolegjin H... master i menaxhimit të institucioneve, do të punonte si mësimdhënëse e lëndës së i... në SHMP “F...”, me 4 orë në ditë, 20 orë në javë dhe 20 orë mësimi në javë. Për sa i përket kohëzgjatjes së kontratës së punës, në nenin 4 pika 1, ishte përcaktuar se i punësuar është i obliguar të filloj punën me datën 04.05.2022 (me kohë të pacaktuar). Pagesa për muaj ishte 459.00€.

E paditura me anë të vendimit Nr... të datës 04.07.2022, e ka shfuqizuar nenin pikën 1 të nenit 4 të kontratës së datës 05.05.2022, lidhur me kohëzgjatjen e kontratës së punës, ndërsa me pikën III të këtij vendimi e njofton paditësen se kontrata e punës e datës 05.05.2022, skadon me datë 31.08.2022 dhe nuk mundë të vazhdohet ngase programi i studimeve “Menaxhimi i Institucioneve dhe Shërbimeve Shëndetësore në Kolegjin H...” nuk është profil për mësimdhënës dhe adekuat për lëndën e infermierisë. Në vendimin e të paditurës nuk kishte këshillë juridike lidhur me të drejtën e ankesës.

Kundër vendimit me të cilin ishte shfuqizuar neni 4 pika 1 e kontratës nr.09-112/08-19484 të datës 05.05.2022, paditësja me datë 04.08.2022 parashtron ankesë duke e kundërshtuar të njëjtin, me arsyetimin se e paditura nuk është bazuar në asnjë provë për të vërtetuar konstatimet se skadimi i kontratës duhet të lidhet me konkursin e vitit 2021/2022 sepse tanimë në fuqi është

kontrata e dt. 05.05.2022 e cila bazohet në Ligjin e Punës dhe Ligjin për Arsim. Vendimi i atakuar nuk mbështetet në asnjë dispozitë ligjore edhe pse i njëjti është titulluar si shfuqizim i nenit 4 të kontratës që ka të bëjë me kohëzgjatjen e kontratës, në fakt është ndërprerje e marrëdhënies së punës pasi që sipas kontratës marrëdhënia e punës është me afat të pacaktuar ndërsa me anë të këtij vendimi, kontrata e punës ndërpritet në fund të muajit përkatësisht me datë 31.08.2022. Ndërprerja e marrëdhënies së punës është e kundërligjshme pa ndonjë paralajmërim sipas afateve të përcaktuara nga neni 69 I Ligjit të Punës.

Gjykata gjeti se lidhur me ankesën e paditëses, e paditura me datë 15.08.2022, kishte marrë vendim me të cilin e kishte hudhur poshtë si të jashtëafatshme për shkak se nuk është parashtruar brenda afatit prej 15 dite nga dita e njoftimit të vendimit siç parashihet me nenin 74 par.2 të Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Sipas fletëdorëzimit të Komunës së Drenasit-Komisioni i ankesave për nëpunësit e shërbimit public N.176 vërtetohet se vendimi 01 Nr... i është dorëzuar paditëses me datë 18.08.2022 ndërsa te rubrika e nënshkrimit kanë qenë të vendosura inicialet e paditëses E M.

Për të vërtetuar lartësinë e pagave të papaguara për paditësin gjykata në cilësinë e provës ka nxjerr ekspertizën financiare të datës 12.02.2024. Detyrat e ekspertit janë përcaktuar mbi bazë të vëllimit që ka kërkuar pala propozuese për nxjerrjen e ekspertizës dhe gjykata. Detyrë e ekspertit ka qenë llogaritja e pagave sipas kontratës së punës nga data 01.09.2021 e deri në nxjerrjen e ekspertizës. Përmes ekspertizës vërtetohet se nga data 01.11.2021, deri në ditën e nxjerrjes së ekspertizës me datë 12.02.2024 pagat neto arrinin në vlerë prej 8,241.66 €, kontributi pensional që duhet të paguhet në Trustin Pensional në emër të paditëses është shuma 461.86 €, kontributi pensional që duhet paguar në Trustin pensional në emër të punëdhënëses është shuma prej 461.86 € dhe tatimi në paga që duhet të paguhet në dobi të buxhetit të Kosovës është shuma prej 533.43 €, në këto kalkulime, eksperti ka zbritur shumat e të ardhurave që ka realizuar paditësja tek marrëdhënia e punës që ajo kishte themeluar.

Eksperti lartësinë e pagave e kishte përcaktuar në bazë të kontratës së punës të lidhur mes palëve ndërgjyqëse, si dhe të dhënave nga llogaria e Trustit Pensional. Gjykata ekspertizën financiare e ka vlerësuar si profesionale dhe të argumentuar mirë dhe të njëjtën e ka pranuar në tërësi si të besueshme

3. Ligji i zbatueshëm

Neni 10 i Ligjit të Punës Nr.03/L-2012 i cili ka hyrë në fuqi me dt. 16.12.2010, përcakton formën dhe periudhën brenda të cilës mund të lidhet kontrata e punës. Kështu në par.1 të nenit 10 të këtij Ligji është përcaktuar “Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar dhe nënshkruhet nga punëdhënësi dhe i punësuar. Kontrata përfshin elementet e përcaktuara sipas nenit 11 të këtij ligji”, ndërsa në par.2 të nenit 10 të këtij Ligji është përcaktuar se “Kontrata e Punës mund të lidhet për: 2.1. një periudhë të pacaktuar; 2.2. një periudhë të caktuar; dhe 2.3. për punë dhe detyra specifike”. Me nenin 10 par.3 të Ligjit të njëjtë është përcaktuar se “Kontrata e punës që nuk përmban kurrfarë hollësish për kohëzgjatjen e vet, duhet të konsiderohet si kontratë në periudhë të pacaktuar”, ndërsa në par 4 të këtij neni të Ligjit të njëjtë është përcaktuar se “Kontrata për periudhë të caktuar nuk mund të lidhet për një periudhë më të gjatë se dhjetë (10) vite”.

Me nenin 67 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212 janë përcaktuar kushtet për ndërprerjen e punës sipas fuqisë ligjore ndërsa në paragrafin 1.3 të këtij neni është përcaktuar se “Kontrata e Punës

sipas fuqisë ligjore, ndërpritet me skadimin e kohëzgjatjes së kontratës”, ndërsa me nenin 68 par.1, të Ligjit të njëjtë është përcaktuar se “Kontrata e Punës mund të ndërpritet me marrëveshje ndërmjet punëdhënësit dhe të punësuarit”.

Neni 70 i Ligjit të Punës Nr.03/L-212, përcakton rastet e ndërprerjes së kontratës së punës nga ana e punëdhënësit, ku ndër të tjera parag.1.4.1 dhe 1.4.2 të nenit 70 thotë se punëdhënësi mund të ja ndërprejë kontratën e punës të punësuarit në periudhën e kërkuar të *paralajmërimit a) në rastet e rënda të sjelljes së keqe të punonjësit dhe b) për shkak të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës*. Ndërsa parag.1.6 i po këtij neni përcakton rastet e ndërprerjes së kontratës së punës pa paralajmërim, a) *i punësuarit është fajtor për përsëritjen e një sjellje më pak serioze ose shkeljes së detyrimeve dhe b) performanca e të punësuarit mbetet e pakënaqshme përkundër paralajmërimit me shkrim*. Parag.2 i nenit 70 të ligjit të lartcekur thotë: *“Punëdhënësi mund ta ndërpresë kontratën e punës në bazë të nën-parag. 1.6, vetëm atëherë kur i punësuarit ka marr përshkrimin në formë të shkruar të performancës së pakënaqshme, një afat të përcaktuar kohor brenda së cilit i punësuarit duhet ta përmirësojë performancën e vet, si dhe një deklaratë se dështimi për përmirësimin e performancës do të rezultojë me largim nga puna pa asnjë paralajmërim të mëtejshëm me shkrim”*. Nenet 78 dhe 79 të këtij ligji përcaktojnë afatet për realizimin e të drejtave nga marrëdhënia e punës fillimisht tek punëdhënësi, e pastaj në gjykatë.

Në kontratën e punës 09-112/08-19484 të dt.05.05.202 të lidhur në mes së paditëses dhe të paditurës, më saktësisht në nenin 4.1 të saj është përcaktuar se *“I punësuar është i obliguar që të filloj punën me datën 04.05.2022 (me kohë të pa caktuar)*. Në nenin 8 par.1 të kontratës është përcaktuar se *“Kontrata e punës të punësuarit do t’i ndërpritet sipas nenit 67, 70, 71 dhe 76 të Ligjit të Punës në fuqi në Republikën e Kosovës”*, ndërsa në par.2 të nenit 8 të kontratës është përcaktuar se *“I punësuarit me rastin e shuarjes së vendit të punës pajtohet se kontrata mund të ndërpritet sipas dispozitave ligjore në fuqi”*.

4. Vlerësimet faktike dhe juridike të gjykatës

Në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar, gjykata ka konstatuar se kërkesëpadia e paditëses është në tërësi e bazuar dhe se e njëjta duhet të aprovet sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerëson se e paditura me rastin e shfuqizimit të nenit 4 pika 1 të kontratës së punës që nënkupton edhe shkëputje të kontratës së punës paditëses, nuk i ka zbatuar kërkesat ligjore që dalin nga dispozitat ligjore të Ligjit të Punës dhe kontrata e punës së paditëses (neni 4), e që kanë të bëjnë me periudhën e marrëdhënies së punës.

Si rezultat i kësaj vendimi për shkëputjen e kontratës së punës paditëses është i paligjshëm, pasi i njëjti është marr në kundërshtim të plotë me dispozitat e Ligjit të Punës, më saktësisht nenit 67 par.1.3, nenit (të përshkruar më lartë). Kjo për faktin se palët ndërgjyqëse në bazë të nenit 4 të kontratës, kontratën e kanë lidhur me kohë të pacaktuar ndërsa paditësja ka qenë e obliguar që punën ta filloj me datë 04.05.2022 në të kundërtën bazuar në paragrafin 2 të këtij neni do të konsiderohej se nuk ka themeluar marrëdhënie të punës por paditësja me datën e lartcekur ka filluar punën deri me datë 31.08.2022.

Gjykata vlerëson se vendimi i të paditurës me të cilin ka shfuqizuar nenin 4.1 të kontratës që ka të bëjë me kohëzgjatjen është i kundërligjshëm sepse e paditura kontratën me kohë të pa caktuar e ka zëvendësuar në kontratë me kohë të caktuar në kundërshtim me nenin 10 par.2, nënpar.2.2 dhe nenin 67 par.1.3 të Ligjit të Punës sepse kontrata është lidhur me vullnetin e dyanshëm të palëve dhe e njëjta nuk ka mundur që atë ta shfuqizoj në mënyrë të njëanshme duke e ndryshuar

kështu formën e kontratës, përveç nëse ndërprerja e saj do të bëhej me marrëveshje të palëve në kuptim të nenit 68 par.1 të Ligjit të Punës. E paditura në rastin e paditëses ka dështuar t'i zbatoj dispozitat ligjore të përmendura më lartë.

Gjykata duke e konsideruar si të kundërligjshëm vendimin e të paditurës për shfuqizimin e nenit 4.1 të kontratës së paditëses që ka të bëjë me kohëzgjatjen e kontratës, e konsideron si të kundërligjshëm edhe konkursin e datës 27.09.2022 në të cilin është kërkuar një mësimdhënës për i... për vitin shkollor 2022/2023 sepse kontrata e datës 05.05.2022 e lidhur në mes të palëve është lidhur para shpalljes së këtij konkursi me afat të pa caktuar dhe e njëjta ka prodhuar pasoja juridike mes tyre, andaj pretendimi i të paditurës se ka anuluar pikën 1 të nenit 4 të kontratës sipas nenit 53 të Ligjit Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative është i pa bazuar sepse ky nen e referohet rasteve kur kemi të bëjmë me anulimin e aktit administrativ, ndërsa në rastin konkret nuk kemi të bëjmë me anulim të aktit administrative por të nenit të një kontrate me afat të pa caktuar, të cilën e paditura nuk ka mundur ta shfuqizoj përveç se me pëlqimin e të dy palëve nëse do të pajtoheshin, ashtu siç është paraparë me nenin 68 par.1 të Ligjit të Punës.

Gjithashtu me provat materiale që iu ofruan gjykatës në shqyrtimin kryesor nga palët ndërgjyqëse gjeti se në këtë çështje nuk kanë ekzistuar asnjë nga kushte ligjore për ndërprerjen e marrëdhënies së punës paditëses nga neni 67, 70,71 dhe 76 të Ligjit të Punës siç janë paraparë edhe me nenin 8 të kontratës së punës të datës 05.05.2022.

Gjykata nuk mundi ta pranoj pretendimin tjetër të paditurës lidhur me ligjshmërinë e vendimit të datës 04.07.2022, përkatësisht pikën III të tij sipas së secilës programi i studimeve menaxhimi i Institucioneve dhe shërbimeve në kolegjin "H..." nuk qenka profil për mësimdhënie dhe adekuat për lëndën e infermierisë pasi që e paditura nuk ka ofruar asnjë provë për ta vërtetuar një pretendim të tillë.

Gjykata me rastin e vendosjes ka pasur parasysh pretendimet e të paditurës kur ka theksuar se padia e paditëses është e pa afatshme por të njëjtat i konsideron si të pa bazuara sepse në bazë të flete dorëzimit të Komisionit të ankesave për nëpunësit e shërbimit publik në Komunën e Drenasit 01Nr... dt. 18.08.2022 është vërtetuar se paditësja vendimin e kishte pranuar në ditën e nxjerrjes së tij ndërsa padinë në gjykatë e ka parashtruar me datë 05.09.2022, andaj rezulton se padia është parashtruar brenda afatit ligjor prej 30 dite sipas nenit 79 të Ligjit të Punës.

Pretendimin e të paditurës se edhe ankesa e parashtruar nga paditësja kundër vendimit të Komunës së Drenasit – Drejtoria e Arsimit Nr... të datës 04.07.2022, është e pa afatshme, gjykata e konsideroi si të pa bazuar sepse në bazë të arsytimit të paditurës të datës 18.08.2022 është theksuar se paditësja paska pohuar pranimin e vendimit të lartcekur me datë 04.07.2022 kur edhe është nxjerrur ky vendim por këtyre pretendimeve nuk ia fali besimin sepse gjykata për ta vërtetuar këtë fakt ka kërkuar nga e paditura me aktvendimin e saj të datës 11.01.2024 që në afatin prej 3 dite t'ia sjellë kopjen e fletëdorëzimit të vendimit të Drejtorisë Komunale të Arsimit në Drenas të datës 04.07.2022 dhe atë të Komisionit të ankesave të datës 18.08.2022 por e njëjta e ka sjellë vetëm fletëdorëzimin e vendimit të datës 18.08.2022 por jo edhe të datës 04.07.2022. Kjo për shkak se nga ankesa e paditëses vërtetohet vetëm data e parashtrimit të saj, e që është me datë 04.08.2022 por nuk dihet data e pranimit të vendimit nr... prej ku edhe rrjedh llogaritja e afatit për ankesë por e paditura nuk e ka sjellë fletëdorëzimin e lartcekur edhe pse barra e të provuarit në këtë rast i ka takuar asaj bazuar në nenin 322 të LPK-së.

Gjykata ka vlerësuar edhe të provat tjera të cilat janë administruar në shqyrtimin kryesor, mirëpo vlerësoi se të njëjtat nuk janë relevante dhe janë pa ndikim në vendosjen meritore të kësaj çështje juridike.

Lidhur me kompensimin e pagave Gjykata vendosi si në dispozitivin e IV duke detyruar të paditurën t'i paguaj paditëses pagat në aplikim të nenit 80 par. 1 pika 1.2 të Ligjit të punës, sipas të cilit: "nëse largimi nga puna vlerësohet si i paligjshëm sipas nenit 5 të këtij ligji, Gjykata mund ta rikthejë të punësuarin në vendin e tij të punës dhe urdhëron kompensimin e të gjitha pagave dhe përfitimeve tjera të humbura gjatë gjithë kohës së largimit të paligjshëm nga puna." Meqë në këtë rast është konstatuar se vendimi i të paditurës është joligjorë, atëherë gjykata konform nenit 55 dhe 80 të ligjit të punës dhe kontratës së punës e ka aprovuar padinë dhe e ka detyruar të paditurën që paditësit t'i kompensojë të ardhurat mujore në lartësi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe atë për periudhën nga data 01.11.2021 deri me datë 12.02.2024, t'ia paguaj shumën prej 8,241.66 €, si dhe në emër të kontributeve pensionale që duhet të paguhet në emër të paditëses në Trustin Pensional të Republikës së Kosovës për muajt nga periudha 01.11.2021 deri më 12.02.2024 shumën prej 923.72 €.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë konform nenit 452.1 të LPK-së dhe TA-së, me të cilin është detyruar e paditura që paditëses t'ia paguaj shumën prej 584 € dhe atë për padi shumën prej 104 €, taksën gjyqësore për padi në shumën prej 60 €, për shpenzimet e ekspertizës financiare 150 € si dhe për dy seanca gjyqësore shumën prej 270 € (nga 135 € për secilën seancë).

Nga të lartcekurat, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, konform nenit 4, 5, 7, 8, lidhur me nenet 143 dhe 146 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË GLLOGOC,
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil,
C.nr.1115/2022, dt.04.03.2024**

**Gjyqtari,
Jeton Krasniqi**

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej 7 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.